



Datë: 09.01.2026
Numër Protokolli: 80/2026

A.nr.1789/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1789/2025, të datës 13.10.2025, të parashtruar nga ankuesi A.A, kundër organit të punësimit: Akademia e Kosovës për Siguri Publikë, në çështjen juridike *“kërkesë nga marrëdhënia e punës”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1789/2025, e datës 13.10.2025 e parashtruar nga ankuesi A.A, ashtu që, **detyrohet** Udhëheqësi i Divizionit të Trajnimeve në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë shqyrtimin e kërkesës së ankuesit të datës 01.08.2025 dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, A.A (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit), përmes postes, më datë 08.10.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 13.10.2025, dhe e regjistruar nën shenjë A.nr.1789/2025, për shkak të heshtjes administrative lidhur me mos shqyrtimin e kërkesës së ankuesit të pashtuar më datë 01.08.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Akademia e Kosovës për Siguri Publike, ndërsa, kjo e fundit, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 6759/2025 të datës 13.10.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën përmes emailit e datës 01.08.2025 nga ankuesin për mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 30.06.2016; Zarfin e datës 0-8.10.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.10.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 27.10.2025; Emailin e datës 24.10.2025 nga Udhëheqësi i Divizionit të Trajnimeve për XH.K.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit me numër protokolli 42 të datës 30.06.2016, është i punësuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Trajnime dhe Zhvillim në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri.

Tutje ankuesi më datë 01.08.2025, i është drejtuar kë kërkesë udhëheqësit të drejtpërdrejt, me kërkesë që në kuadër të ëbfaqes zyrtare të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike të përfshihet emri, mbiemri dhe të dhënat profesionale të trajnerëve/instruktorëve të përhershëm, krijimin e një rubrike të dedikuar për trajnerët/instruktorë e përhershëm duke i ndarë qartë nga instruktorët e jashtme pse të përkohshëm, mirëpo, që sipas thënieve në ankesë nuk ka pranuar ndonjë përgjigje në raport më kërkesën e datës 01.08.2025.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se mbikëqyrësi nuk është përgjigjur në kërkesën e tij siç ka obligim sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kërkon që të aprovet ankesa dhe të detyrohet organi kompetent që të bëjë shqyrtimin e kërkesës së datës 01.08.2025.

Në kuptim të pranueshëmrisë së ankesës Kolegji iu referua:

I. Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë

Neni 27, paragrafi 3: *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.*

II. Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

-Neni 10 paragrafi 2: *2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative..*

-Neni 98 paragrafi 1 dhe 2: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj,*

Neni 97 paragrafi 1: 1. *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes,*

Referuar kuadrit ligjor si më sipër Kolegji i Këshillit vlerëson se organi përkatës i punësimit, në raport me kërkesën e ankuesit të datës 01.08.2025, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, ngase, sipas bazës ligjore si më sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërës prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjisllacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Kështu që, thënë si më sipër e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Udhëheqësin e Divizionit të Trajnimeve në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 01.08.2025 dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.1789/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.A;
- Akademia e Kosovës për Siguri Publike: Udhëheqësit të Divizionit të Trajnimeve dhe Udhëheqësit së Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së.